



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industri*

---

**PROJEKTLIGJI PËR REGJISTRIMIN E PENGUT NË REGJISTËR PËR SENDET E LUAJTSHME**

**DRAFT LAW ON THE REGISTRATION OF A PLEDGE IN THE REGISTRY OF MOVABLE PROPERTY**

**NACRT-ZAKON ZA REGISTRACIJU ZALOGE U REGISTAR POKRETNIH STVARI**



| <b>REPUBLIKA E KOSOVËS<br/>KUVENDI</b>   | <b>REPUBLIC OF KOSOVO<br/>THE ASSEMBLY</b>  | <b>REPUBLIKA KOSOVO<br/>SKUPŠTINA</b>   |
|--|---|---|
| <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p>  | <p>Pursuant to Article 65(1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p>  | <p>U podršci članu 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Usvaja :</p>  |
| <p><b>PROJEKTLIGJIN PËR REGJISTRIMIN<br/>E PENGUT NË REGJISTËR PËR<br/>SENDET E LUAJTSHME</b></p>  | <p><b>DRAFT LAW ON THE REGISTRATION<br/>OF A PLEDGE IN THE REGISTRY OF<br/>MOVABLE PROPERTY</b></p>   | <p><b>NACRT-ZAKON ZA REGISTRACIJU<br/>ZALOGU U REGISTRU POKRETNIH<br/>STVARI</b></p>  |
| <p><b>Neni 1<br/>Qëllimi</b></p>   | <p><b>Article 1<br/>Purpose</b></p>   | <p><b>Član 1<br/>Cilj</b></p>   |
| <p>Me këtë ligj përcaktohet procedura dhe kushtet e regjistrimit të pengut në regjistër për sendet e luajtshme, ndryshimi, kërkimi i informacionit si dhe administrimi i regjistrit të pengut.</p> | <p>This Law sets out procedure and requirements for registration of pledges in the registry of movable property, amendments, and searches of information and administration of the Pledge Registry.</p> | <p>Ovim zakonom se utvrđuje postupak i uslovi registracije zaloge u registru pokretnih stvari, izmena, pretraživanje informacije kao i administriranje registra zaloge.</p> |
| <p><b>Neni 2<br/>Fushëveprimi</b></p>  | <p><b>Article 2<br/>Scope</b></p>   | <p><b>Član 2<br/>Delokrug</b></p>   |
| <p>Ky ligj zbatohet për të gjitha transaksionet ose të drejtat që sipas ligjeve të Kosovës mund të</p>   | <p>This Law applies to all transactions or rights that according to Kosovo law may be</p>   | <p>Ovaj zakon se sprovodi za sve transakcije ili prava koja se prema zakonima Kosova mogu</p>   |



|   |  |   |
|---|--|---|
| <p>regjistruhen në Regjistrin e Pengut.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3<br/>Përkufizimi</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>Ministria</b>- nënkupton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;</p> <p>1.2. <b>Pengu</b>- nënkupton pengun konform ligjit për Pronësi dhe të Drejta të tjera Sendore me numër 03/L-154-2009;</p> <p>1.3. <b>Pengdhënës</b> – nënkupton personin që ka detyrimin dhe që ka në pronësi objektin e pengut;</p> <p>1.4. <b>Pengmarrës</b> – nënkupton personin në favor të të cilit vendoset pengu;</p> <p>1.5. <b>Sendet e luajtshme</b>- nënkupton Sendet e Luajtshme konform ligjit për Pronësi dhe të Drejta të tjera Sendore me numër 03/L-154-2009;</p> <p>1.6. <b>Person</b> - nënkupton çdo person fizik ose juridik;</p> <p>1.7. <b>ARBK</b> - nënkupton Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë;</p> <p>1.8. <b>Divizioni</b> - nënkupton Divizionin për Regjistrimin e Pengut në kuadër të</p> | <p>registered in the Pledge Registry.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3<br/>Definitions</b></p> <p>1. Terms and expressions used in this Law have the following meaning:</p> <p>1.1 <b>Ministry</b> - means the Ministry of Trade and Industry</p> <p>1.2 <b>Pledge</b> – has its meaning according to the Law on Ownership and Other rights number 03/L-154-2009;</p> <p>1.3 <b>Pledger</b> – means the person who has rights and ownership in the pledged property;</p> <p>1.4 <b>Pledgee</b> – means the person to whose favor the pledge is made;</p> <p>1.5 <b>Movable property</b>- has its meaning according to the Law on Ownership and Other rights number 03/L-154-2009;</p> <p>1.6 <b>Person</b>- means any natural or legal person;</p> <p>1.7 <b>KBRA</b>- means Kosovo Business Registration Agency;</p> <p>1.8 <b>Division</b> – means the Pledge Registry Division the KBRA that manages and</p> | <p>registrovati u Registru zaloge.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3<br/>Definicije</b></p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom Zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. <b>Ministarstvo</b>- podrazumeva Ministarstvo Trgovine i Industrije;</p> <p>1.2. <b>Zaloga</b>- podrazumeva zalogu u skladu sa Zakonom o imovini i ostalim stvarnim pravima pod brojem 03/L-154-2009;</p> <p>1.3. <b>Zalogodavac</b> – podrazumeva lice koje ima za obavezu i koje ima u vlasništvu predmet zaloge;</p> <p>1.4. <b>Zalogoprimac</b>– podrazumeva lice u čiju se korist uspostavlja zaloga ;</p> <p>1.5. <b>Pokretne stvari</b> - podrazumeva pokretne stvari u skladu sa Zakonom o imovini i ostalim stvarnim pravima pod brojem 03/L-154-2009;</p> <p>1.6. <b>Lice</b> - podrazumeva svako fizičko ili pravno lice;</p> <p>1.7. <b>KARP</b> – podrazumeva Agenciju za registraciju poslovanja na Kosovu;</p> <p>1.8. <b>Divizija</b> – podrazumeva organ u okviru KARP-a koja upravlja i operiše sa</p> |
|---|--|---|



|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>ARBK-së që menaxhon dhe operon me SRP-në dhe të gjitha procedurat e lidhura me regjistrimin dhe marrjen e informacionit nga SRP;</p> <p>1.9. <b>Regjistri i pengut</b> - nënkupton regjistrin elektronik ku evidentohen dhe ruhen të gjitha të dhënat për sendet të luajtshme;</p> <p>1.10. <b>Sistemi i Regjistrimit të Pengut (SRP)</b> –nënkupton sistemin kompjuterik të Regjistrimit të Pengut të përcaktuar me këtë ligj;</p> <p>1.11. <b>Sistemi i Vjetër i Regjistrimit të Pengut (SVRP)</b> - nënkupton sistemin e vjetër të Regjistrimit të Pengut që ka ekzistuar para hyrjes në fuqi të këtij Ligji;</p> <p>1.12. <b>Regjistrim</b> – nënkupton procesin e regjistrimit të të dhënave të transferuara në Regjistrin e Pengut përmes SRP, si regjistrim të ri ose si ndryshim i ndonjë regjistrimi;</p> <p>1.13. <b>Regjistrim i ri</b> – nënkupton çdo regjistrim të regjistruar në SRP që nuk ka qënë i regjistruar në SVRP.;</p> <p>1.14. <b>Regjistrim i vjetër</b> – nënkupton një regjistrim që ka qënë i regjistruar në SVRP.</p> | <p>operates the PRS and all procedures related to recording and retrieving information from the PRS;</p> <p>1.9. <b>Pledge Registry</b>- means the Electronic registry where data on movable property is recorded and maintained;</p> <p>1.10. <b>Pledge Registry System (PRS)</b> – means the Pledge Registry System which is the computer system of the Pledge Registry established under this law;</p> <p>1.11. <b>Old Pledge Registry System (OPRS)</b> – means Old Pledge Registry System which is the old registry system of the Pledge Registry as existed before this Law comes into effect;</p> <p>1.12. <b>Registration</b> – means process of registration by the transfer of data to the Pledge Registry through the use of the PRS either as an original registration or an amendment to a registration;</p> <p>1.13. <b>New Registration</b> – means any registration that is registered in the PRS and which was not registered in the OPRS;</p> <p>1.14. <b>Old Registration</b> - means a registration that was registered in the OPRS.</p> | <p>SRZ-om u svim procedurama povezanim sa registracijom i dobijanem informacija od SRZ;</p> <p>1.9. <b>Registar zaloge</b> - podrazumeva elektronski registar gde se evidentiraju i čuvaju svi podaci za pokretne stvari;</p> <p>1.10. <b>Sistem Registra zaloge (SRZ)</b> – podrazumeva kompjuterski sistem Registra zaloge određen ovim zakonom.;</p> <p>1.11. <b>Stari sistem Registra zaloge (SSRZ)</b> – podrazumeva stari sistem Registra zaloge koji je postojao pre stupanja na snagu ovog zakona;</p> <p>1.12. <b>Registrovanje</b> – podrazumeva proces registracije podataka transferisanih u Registru zaloge preko SRZ , kao nova registracija ili kao izmena neke registracije;</p> <p>1.13. <b>Nova registracija</b> – podrazumeva svaku registraciju u SRZ, koja nije bila registrovana u SSRZ;</p> <p>1.14. <b>Stara registracija</b> – podrazumeva jednu registraciju koja je bila regisitrovana u SSRZ.</p> |
|--|--|---|



|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>1.15. <b>Certifikata e regjistrimit të pengut (CRP)</b> – nënkupton një dokument të vulosur elektronik të lëshuar nga SRP në formë të konfirmimit të regjistrimit apo rezultatit të kërkimit;</p> <p>1.16. <b>Ekstrakt nga kompjuteri</b> – nënkupton një imazh të prodhuar në mënyrë elektronike nga SRP që përdoret me qëllim të lehtësimit të transferimit të të dhënave në Regjistrin e Pengut ose për shikimin e të dhënave që ekzistojnë në Regjistrin e Pengut;</p> <p>1.17. <b>Identifikimi</b>- nënkupton numrin personal të letërnjoftimit të personave fizik, numrin e regjistrimit të biznesit të lëshuar nga ARBK për personat juridik si dhe për mallrat me numër serik, 25 karakteret e fundit alfa-numerike të numrit serik pa pikësim, viza lidhëse, ndarëse apo shenja tjera, të shënuara ose të vendosura nga ana e prodhuesit;</p> <p>1.18. <b>Llogaria e Përdoruesit</b> – nënkupton një abonim elektronik të ofruar nga SRP i cili ofron qasje në shërbimet e Regjistrimit të Pengut;</p> <p>1.19. <b>Pronari i llogarisë së përdoruesit</b> – është personi në emër të të cilit është e regjistruar Llogaria e Përdoruesit;</p> | <p>1.15. <b>Pledge Registry Certificate (PRC)</b> – an electronically stamped document issued by the PRS in the form of Confirmation of Registration or Search Result;</p> <p>1.16. <b>Printout</b>- means an electronically reproduced image by the PRS that is used for the purpose of facilitating the transfer of data to the Pledge Registry or for viewing data that exist in the Pledge Registry;</p> <p>1.17. <b>Identifier</b> - means: in the case of physical person, the personal identification number that appear on the official identification card of the person; in the case of legal person, the business identification number issued by the KBRA; in the case of Serial Number Property, the last 25 alpha-numeric characters of the serial number without punctuation, hyphens or other markings, permanently marked or attached to the body of the Serial Number Property by the manufacturer;</p> <p>1.18. <b>User Account</b> - means a digital subscription provided by the PRS that provides access to the Pledge Registry services;</p> <p>1.19. <b>User Account Owner</b> – is the</p> | <p>1.15. <b>Sertifikat registria zaloge (SRZ)</b> – podrazumeva jedan dokument elektronski overen izdat od SRZ u formi potvrđivanja registracije ili rezultata ispitivanja;</p> <p>1.16. <b>Izvod iz kompjutera</b> – podrazumeva jedan pregled proizvođen elektronskim putem od SRZ koji se koristi u cilju olakšavanja transferisanja podataka u Registru zaloge ili za pregled podataka koji postoje u Registru zaloge;</p> <p>1.17. <b>Identifikacija</b> – podrazumeva lični broj lične karte fizičkih lica, broj registra poslovanja izdatog od KARP-a za pravna lica kao i za robe pod serijskim brojem, 25 poslednjih alfa-numeričkih karaktera bez interpunkcije, veznih linija, odvojenih linija ili drugih oznaka, označenih ili postavljenih od strane proizvođača;</p> <p>1.18. <b>Korisnički račun</b> – podrazumeva jednu elektronsku pretplatu datu od SRZ koji pruža pristup uslugama Registra zaloge;</p> <p>1.19. <b>Vlasnik korisničkog računa</b> –</p> |
|---|---|--|



|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>1.20. <b>Mallra me numër Serik</b> – nënkupton sende të luajtshme që specifikohen në Aktin Nënligjor;</p> <p>1.21 <b>Sende të tjera të luajtshme</b> - nënkupton sendet e luajtshme që nuk janë të përfshira në definicionin e mallrave me numër Serik.</p>   | <p>person under whose name the User Account is registered;</p> <p>1.20. <b>Serial number property</b> – means items of movable property detailed in any sub-normative act;</p> <p>1.21. <b>Other property</b> - includes any movable property which is not within the definition of serial number property.</p> | <p>predstavlja lice u čije je ime registrovan korisnički račun;</p> <p>1.20. <b>Robe pod Serijskim brojem</b> – podrazumeva pokretne stvari koje se određuju podzakonskim aktom;</p> <p>1.21 <b>Ostale pokretne stvari</b> – podrazumevaju pokretne stvari koje nisu obuhvaćene u definiciji roba pod serijskim brojem.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b><br/><b>Divizioni për regjistrimin e pengut</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b><br/><b>The pledge registry division</b></p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b><br/><b>Divizija za registriaciju zaloge</b></p>  |
| <p>1. Divizioni për regjistrimin e pengut është në kuadër të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë – MTI.</p> <p>2. Organizimi dhe funksionimi i divizionit të regjistrimit të pengut rregullohet me akt nënligjor për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.</p> | <p>1. The Pledge Registry Division is a division within the Kosovo Business Registration Agency – MTI.</p> <p>2. The organization and function of the division of pledge registry division is regulated with sub-normative act for organization and structure of the Ministry of Trade and Industry.</p>        | <p>1. Divizija za registriaciju zaloge nalazi se u okviru Agencije za registraciju poslovanja na Kosovu – MTI.</p> <p>2. Organizovanje i funkcionisanje divizije za registraciju zaloge reguliše se podzakonskim aktom za organizovanje i unutrašnje strukturisanje Ministarstva Trgovine i Industrije.</p>                 |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b><br/><b>Detyrat e divizionit</b></p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b><br/><b>Functions of the division</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b><br/><b>Obaveze divizije</b></p>  |
| <p>1. Divizioni për regjistrimin e Pengut regjistron dhe menaxhon informacionin lidhur me pengun në pajtim me dispozitat dhe kërkesat e këtij ligji dhe është përgjegjëse për kryerjen e funksioneve tjera të përcaktuara me</p>   | <p>1. The Pledge Registry Division records and manages information related to pledges in accordance with the provisions and requirements of this Law and is responsible for performing other functions prescribed by</p>  | <p>1. Divizija za registraciju zaloge registruje i upravlja podacima u vezi sa zalogom u skladu sa odredbama i zahtevima ovog zakona i odgovorna je za izvršavanje ostalih funkcija utvrđenih ovim zakonom.</p>   |



|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>këtë ligj.</p> <p>2. Divizioni për regjistrimin e pengut udhëheqë me procedurat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin më efikas të dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me:</p> <p>2.1.Regjistrimin e pengut përmes SRP-së;</p> <p>2.2.Kërkimin e informacioneve përmes SRP-së;</p> <p>2.3.Lëshimin e CRP-ve, dhe</p> <p>2.4. Kryerjen e të gjitha funksioneve tjera që i janë dhënë divizionit në bazë të këtij ligji.</p> <p>3. Divizioni punon në bazë të SRP-së përmes internetit, duke respektuar rregullat ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë për sigurinë e informacionit elektronik, gjatë lëshimit të dokumenteve elektronike dhe certifikatave të regjistrimit, si dhe për njoftimet tjera dhe komunikatat.</p> <p>4.Divizioni i Pengut është i detyruar të procedojë shërbimet e tij vetëm përmes SRP-së, për të mbajtur të dhënat e plota,të sakta dhe aktuale.</p> | <p>this Law.</p> <p>2.The Pledge Registry Division shall facilitate an efficient implementation of the provisions of this Law as they relate to:</p> <p>2.1 Registration of the pledge through the PRS;</p> <p>2.2 Searching for information through the PRS;</p> <p>2.3 Issuing of PRCs, and</p> <p>2.4 Performing all other functions which are delegated to the Division based on this Law.</p> <p>3. The Division operates based on the PRS and Internet, respecting all Kosovo law on electronic information security, on issuing electronic documents and registration certificates, and on other notifications and communications.</p> <p>4.The Pledge Registry Division is obliged to process its services only through the PRS, in order to maintain complete, accurate and current records.</p> | <p>2. Divizija za registraciju zaloge rukovodi potrebnim procedurama za olakšavanje što efikasnijeg sprovođenja odredaba ovog zakona koje se odnose na:</p> <p>2.1.Registrovanje zaloge preko SRZ;</p> <p>2.2.ispitivanje podataka preko SRZ-a;</p> <p>2.3.Izdavanje SRZ-a, i</p> <p>2.4. Izvršavanje svih drugih funkcija koje su date diviziji na osnovu ovog zakona.</p> <p>3. Divizija radi na osnovu SRZ-a preko interneta, poštujući međunarodna pravila primenjena na Kosovu o sigurnosti elektronskih podataka, tokom izdavanja elektronskih dokumenata i sertifikata registracije, kao i za ostala obaveštenja i saopštenja.</p> <p>4.Divizija zaloge obavezna je da procesuiru usluge samo preko SRZ-a, kako bi se vodili tačni i aktuelni podaci.</p> |
|--|---|--|



| <b>Neni 6<br/>Taksa për shërbimet</b>   | <b>Article 6<br/>Fees for services</b>   | <b>Član 6<br/>Taksa za usluge</b>   |
|---|--|---|
| <p>1. Divizioni përcakton një taksë për shërbimet e ofruara të cilat do të rregullohen me akt nënligjor, të nxjerr nga Ministria.</p> <p>2. Pronari i Llogarisë së Përdoruesit do të depozitojë para në cilëndo llogari të caktuar të Divizionit për regjistrim të Pengut me qëllim të pagesës ndaj Regjistrit të Pengut. Pasi Pronari i Llogarisë së Përdoruesit depoziton para në llogarinë bankare të Regjistrit të Pengut, Regjistri i Pengut do të kreditojë Llogarinë e Përdoruesit me shumën e depozituar.</p> <p>3. Regjistri i Pengut duhet t'i kthejë fondet e pashfrytëzuara nga një Llogari e Përdoruesit vetëm Pronarit të Llogarisë së Përdoruesit dhe atë me rastin e mbylljes së Llogarisë së Përdoruesit.</p> <p>4. Të gjitha të hyrat nga taksat e mbledhura nga divizioni derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.</p> | <p>1. The Pledge Registry determines the fees for services provided, which will be regulated with a sub-normative act issued by the Minister.</p> <p>2. A User Account Owner shall deposit money in any designated Pledge Registry account for the purpose of payment to the Pledge Registry. After the User Account Owner deposits money in the Pledge Registry bank account, the Pledge Registry shall credit the User Account with the amount deposited.</p> <p>3. The Pledge Registry must return unused funds from a User Account only to the User Account Owner and only upon termination of the operation the User Account.</p> <p>4. All revenues from the fees collected by the Pledge Registry shall go to the Budget of the Republic of Kosovo.</p> | <p>1. Divizija određuje jednu taksu za pružene usluge koje će se urediti podzakonskim aktom, donetim od Ministarstva.</p> <p>2. Vlasnik korisničkog računa će depozitovati novac na bilo koji račun određen od Divizije za registraciju zaloge. Nakon što Vlasnik korisničkog računa depozituje novac na bankarski račun Registra zaloge, Registar zaloge će kreditirati korisnički račun u depozitovanom iznosu.</p> <p>3. Registar zaloge mora da vrati neiskorišćene fondove sa jednog korisničkog računa samo vlasniku korisničkog računa i to prilikom zatvaranja korisničkog računa.</p> <p>4. Svi prihodi od prikupljenih taksi iz divizije prelivaju se u budžet Republike Kosova</p> |





| <b>Neni 7<br/>Mbajtja e të dhënave</b>   | <b>Article 7<br/>Maintenance of data</b>   | <b>Član 7<br/>Vođenje podataka</b>   |
|--|--|--|
| <p>Divizioni duhet të mbajë kopje elektronike të arkivit të të gjitha informacioneve të regjistruara në SRP në përputhje me politikat dhe procedurat e Qeverisë së Kosovës.</p>  | <p>The Pledge Registry must keep electronic copies of the entire archive of any information recorded in the PRS in accordance with policies and procedures of the Government of Kosovo.</p>  | <p>Divizija treba da drži jednu elektronsku kopiju arhive svih podataka registrovanih u SRZ u skladu sa politikama i procedurama Vlade Kosova.</p>   |
| <b>Neni 8<br/>Llogaria e Përdoruesit dhe Pronarit të Llogarisë së Përdoruesit</b>  | <b>Article 8<br/>User Accounts and User Accounts Owners</b>  | <b>Član 8<br/>Korisnički račun i vlasnika korisničkog računa</b>   |
| <p>1. Divizioni do të ofrojë shërbimet e tij çdo personi që i është lejuar të ketë Llogari të Përdoruesit me fonde të mjaftueshme në Llogari, për të paguar taksat për shërbimet e kërkuara, siç parashihet në SRP.</p> <p>2. Divizioni do të caktojë Llogarinë e përdoruesve përmes SRP-së.</p> <p>3. Kushtet për Llogari të Përdoruesit janë si vijon:</p> <p>3.1. Të aplikojë në internet përmes SRP-së dhe</p> <p>3.2. Personi të plotësojë kushtet dhe kërkesat që parashihen në këtë ligj.</p> <p>4. SRP-ja do t'i japë Pronarit të Llogarisë së</p> | <p>1. The Division shall provide its services to any person who is qualified to own a User Account with sufficient pre deposited credit to pay the fees for the services requested as provided in the PRS.</p> <p>2. The Division shall assign User Accounts through the PRS.</p> <p>3. The conditions to obtain User Account are as follows:</p> <p>3.1 An application by the PRS; and</p> <p>3.2 This application complies with the requirements of this Law.</p> <p>4. The PRS shall provide the User Account</p> | <p>1. Divizija će pružiti svoje usluge svakom licu kome je odobreno da ima korisnički račun sa dovoljnim fondovima na računu, kako bi se platile takse za zatražene usluge, kao što je predviđeno u SRZ.</p> <p>2. Divizija će odrediti račune korisnika preko SRZ-a.</p> <p>3. Uslovi za korisnički račun su sledeći:</p> <p>3.1. Da aplicira na internet preko SRZ-a i</p> <p>3.2. Lice koje ispunjava uslove i zahteve koji su predviđeni ovim zakonom.</p> <p>4. SRZ će dati Vlasniku korisničkog računa</p> |



|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>Përdoruesit arsyet e refuzimit të një regjistrimi nga SRP-ja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b><br/><b>Informacioni i Llogarisë së Përdoruesit</b></p> <p>Divizioni do të ketë qasje në SRP lidhur me informacionet për çdo Pronar të Llogarisë së Përdoruesit si dhe për të gjitha transaksionet e bëra përmes Llogarisë së Përdoruesit të tij/saj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b><br/><b>Natyra administrative e regjistrimit të pengut</b></p> <p>1. Regjistrimi përmes SRP-së është vetëm veprim formal, informativ dhe administrativ. Divizioni nuk do të verifikojë informacionin e përmbajtur në çdo regjistrim.</p> <p>2. Pronari i Llogarisë së Përdoruesit është plotësisht përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar si rezultat i informacionit të regjistruar në SRP përmes Llogarisë së Përdoruesit të tij/saj.</p> <p>3. Pronari i Llogarisë së Përdoruesit konsiderohet se ka autorizim të plotë për të krijuar, ndryshuar ose anuluar një regjistrim të</p> | <p>Owner with the reasons why a registration is rejected by the PRS.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b><br/><b>User Account information</b></p> <p>The PRS shall make accessible to each User Account Owner the information related to transactions conducted through his or her User Account on periodic basis as requested by the user.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b><br/><b>Administrative nature of pledge information</b></p> <p>1. Registration through the PRS is only a formal, informative and administrative action. The Division shall not verify information contained in any registration.</p> <p>2. The User Account Owner is fully liable for any damage caused as a result of information recorded in the PRS through his or her User Account.</p> <p>3. The User Account Owner is deemed to have full authority to create, amend or cancel a registration made through its User Account.</p> | <p>razloge odbijanaj jedne registracije od SRZ-a.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b><br/><b>Informacija o korisničkom računu</b></p> <p>Divizija će imati pristup u SRZ u vezi sa podacima o svakom Vlasniku korisničkog računa kao i o svim transakcijama sačinjenim preko njegovog/ njenog korisničkog računa.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b><br/><b>Administrativna priroda registracije zaloge</b></p> <p>1. Registracija preko SRZ predstavlja samo formalnu, informativnu i administrativnu radnju. Divizija neće verifikovati sadržajni podatak u svakoj registraciji.</p> <p>2. Vlasnik korisničkog računa u potpunosti je odgovoran o svakoj nastaloj šteti kao rezultat registrovanog podatka u SRZ preko njegovog/njenog korisničkog računa.</p> <p>3. Vlasnik korisničkog računa smatra se da ima puna ovlašćenja formiranje, izmenu ili poništavanje jedne registracije efikasno</p> |
|---|---|--|



|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>bërë efektiv përmes Llogarisë së Përdoruesit të tij.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b><br/><b>Korrigjimi i gabimeve</b></p> <p>1. Përveç nëse parashihet ndryshe në këtë ligj, divizioni nuk do të përmirësojë gabimet asnjëherë.</p> <p>2. Pronari i Llogarisë së Përdoruesit është plotësisht përgjegjës për gjithë informacionin e dorëzuar përmes SRP-së.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b><br/><b>Shqyrtimi i çështjeve kontestuese</b></p> <p>1. Personi që konsideron se Divizioni ose një zyrtar i punësuar aty nuk është duke i përmbushur kushtet e parapara nga ky nen mund të dorëzojnë një kërkesë Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve.</p> <p>2. Kryeshefi është i autorizuar dhe përgjegjës për të shqyrtuar rastin dhe t'i kërkojë Udhëheqësit të Regjistrimit të Pengut të ndërmarrë masat e nevojshme për zgjidhjen e këtij rasti.</p> <p>3. Nëse nuk ka zgjidhje brenda tri (3) dite</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b><br/><b>Correction of errors</b></p> <p>1. Unless otherwise provided in this Law, the Division shall not correct errors at any time.</p> <p>2. The User Account Owner is fully responsible for all information submitted through the PRS.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12</b><br/><b>Review of contesting issues</b></p> <p>1. The person who considers that the Pledge Registry or an officer employed there is not satisfying the conditions provided by this article may submit a request to the Chief Executive of the Business Registration Agency.</p> <p>2. The Chief Executive is authorized and responsible for reviewing the case and asking the Head of the Pledge Registry to undertake necessary measures for resolving this case.</p> <p>3. If there is no resolution within three (3)</p> | <p>urađene preko njegovog korisničkog računa.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b><br/><b>Ispravljanje grešaka</b></p> <p>1. Osim ako je drugačije određeno u ovom zakonu, divizija neće nikad ispraviti greške.</p> <p>2. Vlasnik korisničkog računa u potpunosti je odgovoran za sve podatke predate preko SRZ-a.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12</b><br/><b>Razmatranje spornih pitanja</b></p> <p>1. Lice koje smatra da Divizija ili jedan službenik koji je tu zaposlen ne ispunjava predviđene uslove iz ovog člana, može podneti jedan zahtev Izvršnom načelniku Agencije za registraciju poslovanja.</p> <p>2. Načelnik je ovlašćen i odgovoran da razmotri slučaj i da zahteva od Rukovodioca za registraciju zaloge da preduzme potrebne mere za rešavanje ovog slučaja .</p> <p>3. Ako nema rešenja u roku od (3) radna dana</p> |
|---|---|---|



|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>pune nga pranimi i kërkesës, aplikuesi mund t'i drejtohet Komisionit për shqyrtim të ankesave në kuadër të ARBK-së.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b><br/><b>Shkëmbimi i të dhënave, dokumenteve dhe informacionit</b></p> <p>Ministria lidh marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha autoritetet publike dhe institucionet financiare për mbledhje, mirëmbajtje, shpërndarje të zakonshme të të dhënave dhe informacionit vetëm siç parashihet nga SRP.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b><br/><b>Objekti i pengut të regjistruar</b></p> <p>Objekt i pengut të regjistruar mund të jetë çfarëdo sendi i luajtshëm me vlerë pasurore si dhe ndonjë e drejtë e cila mund të bartet në mënyrë të ligjshme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b><br/><b>Përshkrimi i sendeve të luajtshme në një regjistrim</b></p> <p>1. Përshkrimi i sendeve të luajtshme në një regjistrim është i vlefshëm vetëm nëse e bënë identifikimin e pasurisë.</p> | <p>business days of the receipt of request, the applicant may approach the Commission for the review of complaints within KBRA.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13</b><br/><b>Exchange of data, documents and information</b></p> <p>The Ministry may decide to enter into cooperation agreements with all public authorities and financial institutions for the collection, maintenance and common distribution of data and information as provided by the PRS.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b><br/><b>Pledged property</b></p> <p>Pledged property may be any movable property with value and with rights that can be transferred legally.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b><br/><b>Description of movable property on a registration</b></p> <p>1. A description of property on a registration is valid if it allows identification of the property.</p> | <p>od podnošenja zahteva, aplikant se može obratiti Komisiji za razmatranje žalbi u okviru KARP-a.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13</b><br/><b>Razmena podataka, dokumenata i informacija</b></p> <p>Ministarstvo sklapa sporazum o saradnji sa svim javnim organima i finansijskim institucijama za prikupljanje, održavanje, uobičajenu preraspodelu podataka i informacija samo kako je previđeno od SRZ-a.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b><br/><b>Predmet registrovane zaloge</b></p> <p>Predmet registrovane zaloge može biti bilo koja pokretna stvar u imovinskoj vrednosti kao i neko pravo koje se može preneti na zakonit način.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b><br/><b>Opis pokretnih stvari u jedan registar</b></p> <p>1. Opis pokretnih stvari u jednom registru je važeći samo ako vrši identifikaciju imovine.</p> |
|--|---|---|



|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>2.Përshkrimi i sendeve tjera të luajtshme mund të jetë, por jo të kufizohet, si më poshtë:</p> <p>2.1 Të gjitha sendet e luajtshme të pengdhënësit që ka në pronësi në kohën e nënshkrimit të marrëveshjes së pengut dhe të gjitha sendet e luajtshme të pengdhënësit të siguruara më vonë.”</p> <p>2.2.Të gjitha sendet e luajtshme të ardhshme të pengdhënësit por jo sendet e luajtshme të paprekshme.”</p> <p>2.3.Të gjithë inventarin e pengdhënësit.”</p> <p>3. Kur regjistrimi ka të bëjë me një mall me numër serik, që nuk mbahet për shitje në qarkullimin normal të biznesit të shitësit, kjo do të përfshihet në vendet e caktuara në ekran:</p> <p>3.1.Identifikimi i mallit me numër serik;dhe gjithashtu mund të përfshihen;</p> <p>3.2. Emri i prodhuesit dhe viti i prodhimit të mallit me numër serik.</p> <p>4. Kur regjistrimi ka të bëjë me sende tjera të luajtshme, përshkrimi do të ofrohet në vendin e caktuar në ekranin e SRP-së.</p> | <p>2. A description of Other Property may be, but is not limited to, the following:</p> <p>2.1 All of the debtor’s movable property owned at the time of the signing of the pledge agreement and all of the debtor’s movable property acquired thereafter.”</p> <p>2.2 “All the debtor’s future movable property but not intangible movable property.”</p> <p>2.3 “All the debtor’s inventory.”</p> <p>3. When a registration relates to Serial Number Property that is not held for sale in the ordinary course of the seller’s business, there shall be included in the designated places on the screen:</p> <p>3.1.The Identifier of Serial Number Property; and there may also be included;</p> <p>3.2 The name of the manufacturer; and the production year of the property.</p> <p>4. When the registration relates to Other Property, the description shall be provided in the designated place on the PRS screen.</p> | <p>2.Opis ostalih pokretnih stvari može biti, ali ne da se ograniči u sledećem :</p> <p>2.1 Sve pokretne stvari zalagodavca koje ima u vlasništvu u vreme potpisivanja sporazuma o zalogi i sve pokretne stvari zalagodavca koje su kasnije obezbeđene.”</p> <p>2.2.Sve buduće pokretne stvari zalagodavca, ali ne nematerijalne pokretne stvari.”</p> <p>2.3.Sav inventar zalagodavca.”</p> <p>3. Kada se registracija odnosi na jednu robu sa serijskim brojem, koja se ne drži za prodaju u normalnom prometu poslovanja prodavca, ovo će se obuhvatiti na određenim mestima na ekranu:</p> <p>3.1.Identifikacija robe sa serijskim brojem; i takođe se može obuhvatiti;</p> <p>3.2. Naziv proizvođača i godina proizvodnje robe sa serijskim brojem.</p> <p>4. Kada se registracija odnosi na ostale pokretne stvari, opis će se pružiti na određenim mestima na ekranu SRZ.</p> |
|---|---|--|



| <b>Neni 16</b><br><b>Vlefshmëria e rregjistrimit të pengut</b>   | <b>Article 16</b><br><b>Validity of a registration</b>  | <b>Član 16</b><br><b>Važenje registracije zaloge</b>   |
|--|---|--|
| <p>1. Regjistrimi është i pavlefshëm, nëse nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e këtij ligji.</p> <p>2. Një regjistrim i ri është i vlefshëm vetëm nëse për të është kryer pagesa.</p> <p>3. Regjistrimi është i vlefshëm ndaj çdo personi, nëse regjistrimi paraqitet në një raport si rezultati i kërkimit që është bërë në bazë të identifikimit të këtij personi.</p> <p>4. Regjistrimi është i vlefshëm ndaj çdo malli me numër serik, nëse regjistrimi paraqitet në një raport si rezultat i kërkimit të bërë në bazë të identifikimit të këtij malli me numër serik.</p> <p>5. Informacioni i mëposhtëm duhet të përfshihet në një regjistrim të bërë përmes SRP-së:</p> <p>5.1. Identifikimin e pengmarrësit;</p> <p>5.2. Identifikimin e pengdhënësit;</p> <p>5.3. Përshkrimin e sendeve të luajtshme siç parashihet në këtë ligj.</p> | <p>1. A registration is invalid unless it complies with all the requirements of this Law.</p> <p>2. A new registration is valid only if it is paid for.</p> <p>3. A registration is invalid against any person unless the registration is disclosed on a search result report of a search conducted based on the Identifier of this person.</p> <p>4. A registration is invalid against any Serial Number Property unless the registration is disclosed on a search result report of a search conducted based on the Identifier of this Serial Number Property.</p> <p>5. The following information must be included on a registration made through the PRS:</p> <p>5.1. Identification of the creditor;</p> <p>5.2. Identification of the debtor;</p> <p>5.3. Description of the property as provided in this Law.</p> | <p>1. Registracija je nevažeća, ako nije u skladu sa svim zahtevima ovog zakona.</p> <p>2. Jedna nova registracija je važeća samo ako je za nju izvršena uplata.</p> <p>3. Registracija je važeća prema svakom licu, ako se registracija podnese u jednom izveštaju kao rezultat pretraživanja koje je urađeno na osnovu identifikacije ovog lica.</p> <p>4. Registracija je važeća prema svakoj robi sa serijskim brojem, ako se registracija podnese u jednom izveštaju kao rezultat pretraživanja urađenog na osnovu identifikacije ove robe sa serijskim brojem.</p> <p>5. Dole navedeni podatak treba se obuhvatiti u jednom registru sačinjenom preko SRZ-a:</p> <p>5.1. Identifikacijom zalogoprimca;</p> <p>5.2. Identifikacijom zalagodavca ;</p> <p>5.3. Opisom pokretnih stvari kako je predviđeno u ovom zakonu.</p> |



|   |  |  |
|---|--|--|
